



Nr. 7 Prot.

Dt.26.01.2019

Objekti: Njoftim për shpalljen e listave zgjedhore nga kategoria student për sekretaritë mësimore në UART

VENDIM

Bazuar në Vendimet e Senatit Akademik nr. 05 me datë 23. 01. 2019, për “Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për dy vende vakante, për anëtar të Senatit Akademik, kategoria student, në Universitetin e Arteve”, Vendimin e Senatit Akademik nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për “Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për 1 vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve” dhe urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 110, dt. 15.03.2016 dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”:

KIZ njofton sekretaritë mësimore të: Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Artit Skenik, Fakultetit të Arteve të Bukura, përpilimin dhe shpalljen e listave zgjedhore të kategorisë studentë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë sipas viteve dhe programeve përkatëse të studimit, duke filluar nga viti i parë e deri në vitin e pestë.

Listat duhet të afishohen dukshëm në mjediset e fakulteteve përkatëse brenda datës 31.01.2019. Sekretaritë duhet të dorëzojnë në KIZ një kopje të printuar të listave bashkëngjitur me një kopje elektronike (Cd).

Kryetar

Alert Celoaliaj

Anëtar Andrea Canaj

Anëtar Laert Qazimi



Sekretar

Viktor Ferraj

Anëtar Harri Aleksi

Anëtar Genc Përmeti